

Data 23.06.2025

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË PUBLIKE - Mbi kufirin e lartë monetar -
Prokurim me mjete elektronike**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtim rruga Kashar - Nyja Vaqarr Faza II”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime
ndërtimi për autostrada, rrugë 45233100-0**

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,748,988,532.55 (dy miliard e shtatëqind e dyzet e tetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë e pesë) **Lekë, pa TVSH;**

Në Euro: 28,050,903.39 (njëzet e tetë milion e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e tre pikë tridhjetë e nëntë) **Euro pa TVSH.**

Në bazë të Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024 Autoriteti/Enti Kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për shpenzimet kapitale për vitet 2025-2027 (Shkresa e MIE Nr. 1343/3 prot, datë 27.02.2025). Bazuar në Nenin 42, pika 1 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 (e ndryshuar) “Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve”. Në rastin konkret, teknikisht është e pamundur të ndahet në lote. Ndarja në lote e objektit do të komplikonte rakordimin e punimeve civile dhe proceseve të punës, e për pasojë do sillte risqe të mëdha për përfundimin e veprës në kohë dhe në cilësi.

Në zbatim të pikës 2 të Nenit 56 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe pikës 3 të Nenit 24 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Autoriteti Kontraktor do të publikojë njoftimin e kontratës në gjuhën Angleze në një gazetë zyrtare të Bashkimit Europian.

Në zbatim të pikës 2 Neni 12 i VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Autoriteti Kontraktor ka konvertuar vlerën limit të kontratës në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë data **23.06.2025**, ora **12:39:01**

Autoriteti Kontraktor ndalon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

- Për të provuar përvojën e mëparshme **(punë të ngjashme):**
 - Pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”
- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale **(licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës):**
 - Pika 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

Argumentimi ligjor: Në mbështetje të Nenit 84, pikat 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Neni 90, pikat 5 dhe 6 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar)

Nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera sipas pikës 2.16 të DST-ve.

Argumentimi teknik: Autoriteti Kontraktor për zbatimin dhe realizimin e objektit me sukses dhe cilësi do të gjykojë mbi **përvojën e mëparshme të operatorit, i cili do të zbatojë këtë kontratë dhe jo në përvojën e një operatori tjetër, i cili i mbështet thjesht për t’u kualifikuar, por nuk merr përsipër të kryej asnjë shërbim gjatë zbatimit.** Do ishte një vlerësim jo korrekt nga ana e autoritetit nëse do lejonte mbështetjen në përvojë të ngjashme dhe operatori, i cili do të fitonte kontratën nuk do të kishte përvojën e duhur, si dhe për më tepër të mbajë përgjegjësi për mos përmbushje të kontratës. Gjithashtu, lejimi i mbështetjes në subjekte të tjera përbën një risk shumë të madh për zbatimin e kontratës dhe përfundimin e saj me standard dhe cilësi.

Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë. II.

Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente: - Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri; - Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë; - Kapacitetet financiare. **Duke qenë se pikat e licencës përfitohen si rezultat i eksperiencës dhe cilësisë, ato i përkasin vetë shoqërisë, dhe shfrytëzohen në harmoni me të gjithë komponentët që përbëjnë këtë shoqëri.**

Duke u nisur nga këto fakte, gjykojmë se një operator ekonomik nuk do të realizonte me sukses zbatimin e kontratës në qoftë se nuk do të dispononte pikën e licencës për atë kategori dhe përvojën e ngjashme. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se AK nuk kufizon mundësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë për të përmbushur këto kriteret.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto ¹ X

Sipas rëndësisë:

Çmimi ☐	pikët 60
Metodologjia ☐	pikët 5
Stafi / Organizimi i Kompanisë ☐	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social ☐	pikët 10
Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit ☐	pikët 10

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 60 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b ,3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [60 pikë]

¹Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024)

2. Metodologjia [5 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë mënyrën që do të ndjekë kompania me kapacitetet dhe eksperiencën e saj në përmbushjen e punimeve. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm.

Faktorët favorizues: Identifikoni dhe përshkruani faktorët që do të ndikojnë pozitivisht në realizimin e punimeve. Këto mund të përfshijnë përvoja të mëparshme të suksesshme, qasje inovative, ose bashkëpunime me partnerë të besueshëm.

Pajisje inovative: Prezantoni pajisjet dhe teknologjitë e avancuara që kompania juaj do të përdorë për të përshpejtuar dhe përmirësuar cilësinë e punimeve. Kjo mund të përfshijë makineri të reja, ose metoda të reja të ndërtimit.

Metodologji punimesh: Përshkruani metodologjitë dhe proceset që do të ndiqni për të siguruar që punimet të përfundojnë në kohë dhe me cilësi të lartë. Kjo mund të përfshijë planifikim të detajuar, menaxhim të efektshëm të burimeve, dhe monitorim të vazhdueshëm të progresit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).

Kontraktori duhet të përgatisë Metodologjinë e Punëve për të plotësuar kërkesat e zbatimit të projektit në kohën, sasinë dhe cilësinë e duhur. Metodologjia që ndiqet për realizimin e punimeve synon të garantojë cilësinë e ndërtimit të objektit, të kontrollojë cilësinë e materialeve që do të përdoren në objekt referuar me specifikimet teknike të projektit, kontrollin e zbatimit të grafikut të punimeve, kontrollin sasior të volumeve të preventivit, si dhe zgjidhjen e problemeve teknike apo organizative që dalin gjatë zbatimit të punimeve në objekt. Metodologjia do të ketë një rol të

rëndësishëm në zbatimin e projektit. Metodologjia prezanton, gjithashtu, detyrat dhe strukturën organizative të grupit të zbatimit të punimeve. Përmban menaxhimin dhe përgjegjësitë kryesore të grupit të zbatimit të projektit.

3. Stafi / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike [13 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshtë:

- I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]
- II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]
- III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]
- IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të lëshuar nga punëdhënësi të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [2 pikë]

*Shënim: Për përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjisë të ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh përbëjnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024). Operatori Ekonomik për t’u vlerësuar për këte kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën e stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, ku cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës.

2. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / eficiente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [5 pikë]

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).

Standardi gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur në mënyrë të posaçme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket çështjeve të impaktit në mjedis dhe social që përfshihen në punimet që do të kryhen. Operatori ekonomik duhet të ndjekë parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit duke përdorur Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si një instrument për mbrojtjen e mjedisit, duke identifikuar dhe vlerësuar efektet e mundshme direkte dhe indirekte për parandalimin e tyre.

Operatori ekonomik kryen mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet parandalimit, zbutjes dhe kompensimit të dëmeve të projekt propozimit, i cili mund të shkaktojë efekte negative të rëndësishme mbi mjedisin për shkak të madhësisë, natyrës ose zonës ku parashikohet të zbatohet.

3. Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit [10 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

a) Periudha e garancisë së punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vite) [5 pikë]
Kjo, në mbështetje të *Udhëzimit Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”*.

Pikët për këtë nënkriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k5}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k5}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k5}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

b) Periudha e mirëmbajtjes rutinë në përputhje me periudhën e garancisë [5 pikë]

Pikët për këtë nënkriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k5}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k5}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k5}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar t'i zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM Nr. 285/2021 (i ndryshuar), kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur, e cila nuk përmend afatin e përcaktuar, do të vlerësohet minimalisht për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

Çdo ofertues, i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe mirëmbajtje rutinë, për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet me formulën e paraqitur në nënkriteret e mësipërme.

Shënim: Operatori ekonomik pjesëmarrës për vlerësimin me pikë për këto dy nënkritere duhet të vetëdeklarojë se do të kryejë edhe mirëmbajtjen rutinë gjatë periudhës së garancisë.

Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kriteve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret), duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas Shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP (ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024); Nenin 39, pika 6/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar)

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron

vjetore për vitet financiare **2022, 2023, 2024** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024), si dhe në Nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “E Hapur - punë publike - Mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma “a” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ku përcaktohet: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Gjithashtu, është përcaktuar jo më e vogël se vlera e kontratës për të rritur numrin e konkurrentëve në procedurë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ku përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009), **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024), si dhe Nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, (i ndryshuar), si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në Nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”

“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën

kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

- a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje:
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore;
 - Aktin e kolaudimit

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
- Akt kolaudimi objekti;

Shënim: Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

2.3.1/2 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

2.3.1/3 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat..50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të Nenit 88, pika 1 e VKM 285/2021 (i ndryshuar), parashikon:

“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të Nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë:

2.3.2/1 Kategoritë e mëposhtme

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1-E	Punime gjurmimi në tokë
2	NP-4-G	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
3	NP-5-F	Punime nëntokësore, ura, vepra arti
4	NP-9-C	Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime
5	NP-11-A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatoreve, linja TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
6	NP-12-E	Punime të inxhinierisë së mjedisit
7	NS-6-A	Sinjalistika rrugore jondriçuese
8	NS-7-D	Barriera dhe mbrojtja rrugore
9	NS-9-A	Punime strukturore speciale
10	NS-18-D	Punime topogjeodezike

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024); Nenin 39, pika 6/a, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe me VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për

kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), Neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1-E	Punime gjërmimi në tokë	Punime gjërmimi në trupin e rrugës dhe në vepra arti.	201-400 milion	398,071,146.53
NP-4-G	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	Përfshin gjithë punimet në rrugë.	Mbi 800 milion	2,618,084,316.71
NP-5-F	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Punime për ndërtimin e urave, tombino hidraulike	401-800 milion	401,427,004.49
NP-9-C	Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime	Punime sisteme të drenimit	51-100 milion	70,617,128.34
NP-11-A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	Punime për ndriçimin mbi veprat e artit	0-20 milion	881,604.44
NP-12-E	Punime të inxhinierisë së mjedisit	Punime mbjellje dhe gabiona, etj	201-400 milion	206,272,522.37

NS-6- A	Sinjalistika rrugore jondriçuese	Punime sinjalistike vertikale dhe horizontale	0-20 milion	14,599,941.01
NS-7-D	Barriera dhe mbrojtja rrugore	Vendosje guardrail, new jersey, parmakë.	101-200 milion	175,824,130.2
NS-9-A	Punime strukturore speciale	Punime për pilotat	0-20 milion	15,461,244
NS-18-D	Punime topogjeodezike	Punime në trupin e rrugës	101-200 milion	130,904,215.84

2.3.2/2 Personelin kryesor **drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (profili Strukturist)**
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- 1 (një) Inxhinier Elektrik**
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog**
- 1 (një) Inxhinier Mjedi**
- 1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet**
- 1 (një) Inxhinier Mekanik**

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar me VKM Nr. 545, datë 04.09.2024), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik lidhet ngushtësisht objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë

afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Inxhinierët janë përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **200 (dyqind) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën **Maj 2025**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Maj 2025**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Maj 2025**.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohë është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të

paktën 200 persona, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementët e strukturës së kostos (materiale, punëtori, makineri, transport) zëri i fuqisë punëtore zë rreth 20% të kostos.

2.3.4 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (**jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë**), si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Ndërtimi (profili Strukturist)

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

1 (një) Inxhinier Elektrik

1 (një) Inxhinier Gjeolog

1 (një) Inxhinier Mjedisi

1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet

1 (një) Inxhinier Mekanik

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM Nr. 285,

datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”**, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht,

Kërkesa e mësipërme mbështetet në Ligjin Nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", si dhe Ligjit Nr. 10431, datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatori/ët ekonomik/ë që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentet përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM Nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

2.3.6 Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një **deklaratë** (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik të punimeve** (Inxhinier Ndërtimi me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: **Diplomë, Librezë pune dhe kontratë pune.***

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe nenit 39, pika 6/c) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe bazuar në Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim" e ndryshuar me Ligjin Nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa" me anë të këtij

kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të përcaktojnë Drejtuesin Teknik që do jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 8</i>
2	<i>Kamionçinë</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 3</i>
3	<i>Kamion me vinç</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 3</i>
4	<i>Fadromë me goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 3</i>
5	<i>Greider</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
6	<i>Autobot uji</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
7	<i>Autobetoniere</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 4</i>
8	<i>Autopompë betoni</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
9	<i>Autobitumatriçe</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
10	<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
11	<i>Eskavatorë me goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 4</i>
12	<i>Eskavatorë me zinxhir</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 4</i>
13	<i>Rul gomë-hekur</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
14	<i>Rul gomë-gomë</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
15	<i>Rul hekur-hekur</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
16	<i>Makineri vijëzimi</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
17	<i>Makineri për vendosje guardrail</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
18	<i>Autokompresor</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
19	<i>Sondë shpimi me diametër Ø 1200 mm</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
20	<i>Vinç me kapacitet jo më pak se 50 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
21	<i>Fabrikë Betoni (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)</i>	<i>në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi</i>	<i>Copë 1</i>
22	<i>Fabrikë asfalti (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)</i>	<i>në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi</i>	<i>Copë 1</i>
23	<i>Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)</i>	<i>në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi</i>	<i>Copë 1</i>

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të Nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe Nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018).

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori/et ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- SSH EN ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- SSH EN ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
- SSH EN ISO 45001:2023 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024), sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ku përcaktohet:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.4.2 Grafiku i punimeve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024), Nenin 39, pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2.4.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Shtetit, e përcaktuar edhe te pika 2.10 e DST-ve. Financimi është parashikuar në buxhetin 2025-2027, por vlera e parashikuar e kontratës kalon 3 (tre) vjeçarin, edhe pse afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e Nenit 4, pika 38/b dhe Nenit 36, të LPP (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024), si dhe nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose

shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP (i ndryshuar). Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike do të hartohen dhe do të argumentohen për çdo zë punimi të kësaj vepre sipas preventivit të hartuar nga projektuesi.

Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zërat e punimeve janë pjesë e pandarë e DST.

Në çdo rast nëse janë përmendur markë prodhimi ose proces i veçantë pranohen edhe ekuivalent.